...«Bota femërore» është frymëmarrje e kësaj jete e megjithatë ngulfaten të drejtat e saj! Ajo i jep nuanca shumëngjyrëshe përditshmërisë sonë dhe përjetëson jetën mbi glob e megjithatë globalisht jetën ia errësojnë! Më shumë këngë, më shumë respekt, më shumë liri, më shumë përkushtim, më shumë dashuri... për botën femërore.

- autori

MEHMET BISLIMI - LIRIKAT E FJETURA

MEHMET BISLIMI

LIRIKAT E FJETURA

(POEZI)

Mehmet Bislimi

LIRIKAT E FJETURA

Mehmet Bislimi

LIRIKAT E FJETURA

Redaktor:
Prof. Dr. Begzad Baliu

Lektor:
Emin Halimi

Recensent:
Adnan Asllani

Kopertina dhe faqosja:
Sabir Krasniqi

Punimi në ballinë:
Bryce

Botues:
PPG "Shkrola Print"
Prishtinë

Copyright & 2013
Autori

Mehmet Bislimi

LIRIKAT E FJETURA

POEZI

... «Bota femërore» është frymëmarrje e kësaj jete e megjithatë ngulfaten të drejtat e saj! Ajo i jep nuanca shumëngjyrëshe përditshmërisë sonë dhe përjetëson jetën mbi glob e megjithatë globalisht jetën ia errësojnë! Më shumë këngë, më shumë respekt, më shumë liri, më shumë përkushtim, më shumë dashuri... për botën femërore.

- autori

FJALA E REDAKTORIT

Ironia e tekstit

Mehmet Bislimi, Lirikat e fjetura, Prishtinë, 2013.

Dy dekadat e fundit letërsia shqiptare ka pasur prurje të pazakonshme në fushë të saj, si me numrin e autorëve ashtu edhe me numrin e veprave të shkruara dhe, madje edhe me numrin e veprave të përkthyera. Arsyet e këtyre prurje janë thënë jo njëherë dhe mund të tipologjizohen edhe më tej, si për modelin e ardhur nga radhët e shkrimtarëve ashtu edhe për prirjen semantike të veprave të shkruara a të përkthyera.

Shkrimtari Mehmet Bislimi është njëri prej krijuesve të dekadës së fundit, i cili shquhet për trashëgiminë jetësore të biografisë së tij, për modelin se si ka hyrë në letrat shqipe dhe për prurjet estetike të krijimtarisë së tij. Në letërsinë shqipe ai hyn me konceptet intelektuale të krijuesit, që në shoqërinë shqiptare ka sjellë më parë se sa mendimin kritik për letërsinë, mendimin kritik për lirinë e të qenit shqiptar. Duke i takuar radhës së atyre krijuesve që mendimin dhe angazhimin e tyre jetësor e

konsideronin mision, ai la mënjanë për shumë vjet anën shpirtërore subjektive deri në fund të Luftës çlirimtare të Kosovës. Por, kur misionin e tij si shumë pjesëtarë të Lëvizjes për Çlirimin e Kosovës e konsideroi të përmbyllur, së paku si një akt të dramës së madhe kombëtare, Mehmet Bislimi hapi portën e madhe shpirtërore dhe pse jo edhe mjeshtërinë e tij prej analisti, hulumtuesi, studiuesi, poeti dhe para se gjithash krijuesi letrar. Në këtë rrjedhë ai krahas poezisë botoi monografi për dëshmorët, vëllime me prozë të trashëgimisë popullore, vëllime me analiza politike të karakterit nacional etj. A mund të thuhet se kjo është arsyeja pse krijimtaria e tij letrare është pasuruar me veçori të letërsisë gojore dhe struktura të veçanta gjuhësore e semantike të lirikës së saj. Dhe pse të mos thuhet se kjo mund të jetë edhe premisa e një shtrese të përhershme etike me bazë në të menduarit tradicional, me të cilën shquhet gjithashtu një pjesë e poezisë së tij.

Vëllimit me poezi Lirika të fjetura, ju prinë një Hyrje jo shumë e zakonshme në fushë të letrave shqipe. I kujdesshëm që të mos trazojë zemrat e lexuesve të poezive të tij të fjetura ndër dorëshkrime zemre, ai bën një hyrje shpjeguese me të cilën dëshmon se këto poezi i janë kushtuar gjinisë tjetër, botës së urtë dhe të veçantë të saj, si dhe kujtesës që e përcjell respektin për të.

Vëllimi poetik me titull Lirikat e fjetura, është strukturuar nga një numër ciklesh dhe poezish, të cilat përveç me ndonjë esencë motivuese nuk shquhen për ndonjë nuancë tjetër stilistike, gjuhësore a metrike, prandaj ashtu sikur rrinë të ndara në cikle të shumta, ashtu edhe do të mundë të shquheshin si një tërësi tematike, stilistikore dhe perceptuese. Le të shohim në fillim vetëm strukturën motivore të fjalësit a togfjalëshit, me të cilët është bërë ndarja e cikleve poetike: ***Ndjenjë e vakët, Aromë ftoi, Thyerje në pasqyrë, Epikë e përflakur, Lirikë shpirtërore, Falni lirikat, Atje ku nuk bie borë, Autorë të sakrifikuar, Hijet e shpirtit, Zanoret e bardha, Lirikat e fjetura dhe Kumbim kambanash***. Prej titujve të vënë nuk është vështirë të shihet jo vetëm mesazhi poetik por edhe simbolika e trashëguar e tabanit tradicional, qoftë e letërsisë popullore qoftë e letërsisë së shkruar, kryesisht rustikale, në njësitë leksikore: vakët, ftua, epikë, shpirt, përflakje, bardhë, fjetur, falje, kambanë; po edhe largim nga ajo: pasqyrë, sakrificë, zanore, hije shpirti etj., të cilat mjeshtri ynë i ka strukturuar me kujdes dhe me përkushtim të rrallë, si pak krijues të brezit të tij.

Diskutimi i poezisë së tij qoftë brenda cikleve, qoftë më vete, do të mundë të sillte një ide më të plotë për tërësinë estetike e konceptuar jo vetëm për një poezi, po edhe për tërësinë e saj.

Ato marrin nismë që nga kujtesa për sytë e një fëmije të mbushur dashuri, te rinia e mbarsur me ëndrra djaloshare e që fluturojnë mbi horizont dhe përmbyllen me 'marrëzitë' e moshës së bardhë. Poezitë e identifikuara kryesisht me përemra, ëndrra, përkushtime personale, ndjenja të përziera, moshë, plagë zemre të ringjallura thellë në ndjenjat e një moshe të shtyrë etj., janë ato që e përcaktojnë përbërësin e motiveve, temave, ideve dhe mesazheve të përcjella me një pasuri shenjash dhe etiketash etike të traditës sonë. Të kësaj natyre janë poezitë ***Asaj, Fotografia, Ka vite, Plagët, Brengë e vjetër, Kujtime, Moshë e vite, Pa dashje (një nga poezitë më të bukura të këtij vëllimi), Ëndërr e vjetër, Sorkadhes etj***., si këto, me të cilat identifikohen jo vetëm motivet dhe ciklet e poezive, por edhe tërësia tematike dhe estetike e këtij vëllimi. Janë vargje të mallit dhe të kujtesës me të, për të cilat autori ynë që në fillim kërkon ndjesë, sepse:

*"**nuk dua t'ia lëndoj***
ëndrrat e saja të bardha
***me ndjenjat e mia të mallit të parë**",*

thekson në një nga poezitë e para, si për të plotësuar Parathënien e shkruar në hyrje të këtij vëllimi.

Krijues me dhunti të theksuar për përdorimin e humorit tradicional dhe sarkazmës letrare, Mehmet Bislimi është shquar në mënyrë të veçantë për përshtrirjen e saj edhe në letërsinë artistike, në të vërtetë edhe në poezitë e kësaj përmbledhjeje. Si në pak vëllime të poezisë sonë këta përbërës letrarë të veshur në të shumtën e rasteve me vlera etike, të dala kur nga formulimet popullore e kur nga gjedha e shkruar filozofike, zënë vend të rëndësishëm, për të mos thënë, bëhen simbolika e strukturës poetike në poezinë e tij. Pa satirën, me të cilën e ka veshur pothuajse gjithë sistemin poetik të tij, vështirë se do të mundë të shquhej në këto përmasa universi vetjak i poezisë së Mehmet Bislimit, përkundrazi. Janë pikërisht këto vlera, të cilat e cilësojnë edhe Lirikën e fjetur, poezinë e kujtesës së vonuar a të rishfaqur dhe lirikën besoj më sublime të poetit të zbardhur ndër vite:

*"**muzat e mesnatës me joshje***
në befasi i zura
më lusnin që t'i falja
jo
nuk i fala
***në poezi i vura**"*

Në të vërtetë, poezi të kësaj natyre a të këtyre motiveve, as nuk janë shkruar për herë të parë as nuk janë shkruar vetëm në gjuhën shqipe.

Por poezitë e krijuesit tonë janë të veçanta, sepse ato zhvillohen paralelisht në dy rrafshe: rrafshi i parë përshkohet përgjithësisht nga marrëzia e të qenit njeri i dashuruar, me vitet dhe me aktin dashuror, si një dukuri e përjetshme dhe më në fund si një faktor fiziologjik, që e bënë të qenësishme edhe sarkazmin; ndërsa rrafshi i dytë që zhvillohet pothuajse paralel me të parin, është vetëdija për 'bëmat' e narratorit dhe ndërdijen për kodin etik të kësaj bëme. Janë dy përmasa e paralele të dala mrekullueshëm nga ky krijues, për të cilat shpresoj të shkruaj një herë tjetër më gjerësisht.

Le të jetë prandaj kjo edhe vetëm njëra prej arsyeve pse sot mund të thuhet se autori i këtij vëllimi bën një hap cilësor në poezinë shqipe, në të vërtetë në afrimin e parametrave të traditës së poezisë shqipe me vlerat estetike të poezisë moderne të saj.

Prishtinë, shkurt 2013

Prof.asoc. dr. Begzad BALIU

NDJENJË E VAKËT

Asaj

kohë e largët
ndjenjë e vakët
lozonjare herë
herë e saktë

kujtime të hershme rinore
çastet të ëmbla përcjellë
pa dashje
ëndërr e mbështjellë
si dhuratë
më erdhe për shqetësim këtë natë
më nxore djerset nga balli
ëh
ty lumi të marrtë
ç'më paska djegë malli

Atë

me syrin e arsyes e shikoja
aritmi zemre
rinumërim nga e para
sprovë që më trembe
nuk dua t'ia lëndoj
ëndrrat e saja të bardha
me ndjenjat e mia të mallit të parë
nuk lejoj
ndjenjat nuk i fus në lojë
as një herë
atë
nuk dua ta lëndoj

Një ëndërr

ëndrrat e bardha
edhe në kohën e pleqërisë
mes kujtimeve të venitura
të mirëseardhura
po
ikën
vitet e rinisë

në derën e vjetër prej druri
ëndrrat
me ndrojtje trokasin
për lojën e lënë në gjysmë
ëndrrat lozonjare
prapë
në derë na trokasin
në orët e vona
na kujtojnë
s'na braktisin
s'na harrojnë

Fotografia

fotografi e saj
përtej horizontit blu
plagët e mbyllura rihapë
kohëra të largëta rinore
buzëqeshje e ngrirë
si për inat
kujtimet shprush
edhe këtë natë
me bengun e kafet
në gushë

shumë kërkova e s' të gjeta
në rrugët e pendimit
një ndjenjë krejt e shpërthurë
si ti askush
edhe sot
si dikur
me bengun e kafet
në gushë

Ka vite

të mbyllen prapa murit
butësi femërore
kohë e ligë në theqafje
të kishte ndrydhur
e lënë pas dore

vrasje e rëndë në emër të moralit
mëkat i paparë
a vritet sorkadhja e malit
që sjell plleshmërinë
lojë me idhujt
lojë e paskrupullt me Kodin Etik
lojë me perëndinë

Pikëllim

lajmi se ti nuk do vishë
më erdhi nga andej telefoni
gjumit i thash ik
si ndër leqe
në prehrin e pritjes
vetmia më zuri
ëh
pritje me shije të keqe
pelin në buzë më vuri

tani edhe kur cingëron telefoni
nuk e hap më
lajmin për mosardhjen tënde
e mora vesh
ka vite që pres një zile
e nuk "cingëron" më
asnjëri prej nesh
a thua do na thërrasë dikush
për të na thënë
ndihuni
se do ikim nga kjo jetë

Pritje

me çiltërsinë e shpirtit
pritën ato
kthimin e burrave
nga syrgjyni
kurbeti
burgu e mali

me flokun mbi supe
si petkat e bardha larë
në lotin e kripur
kristal pritje ngrirë
në gjoksin e tyre pesha e pritjes
kallë
si prapa derës së hekurt
përnjëherësh
dashuri e vuajtje
ndryrë
nga malli i pritjes
kallë

Ta shpëtojmë dashurinë

urrejtjen ta shtypim me gurë
dashurinë ta shpëtojmë
më pastaj do mblidhemi
për të kërkuar
rrënjën e atësisë
kush ishte babai i urrejtjes
dhe
kush i dashurisë

luteni
mos i hyni në hak njeriut
as perëndisë
dashuri falni botës
jetë
rini
çiltërsi

Vite

zili të kam
mes shoqeve në garë
bukuri
që ndiqni njëra- tjetrën
një jetë në radhë
e reja ndoqi të vjetrën

e rëndë
edhe në vitet e mia
zemra s'më bënë
të heq dorë
nga rinia

AROMË FTOI

Mungojnë

në odën e vjetër çiftelia
ku trimi këndonte baladat
mungon

në dhomën e nuses arka e saj
aromë e ftoit ku ajo nusëronte
mungon

nuse e dhëndër
gjakun e lirisë Kosovë
ta falen

e bardha e tokës sonë pjellore
vellon tënde
nuset e Kosovës
në gji po e mbajnë
rite dasmash
në shkretni mos mbetshi
Kosovë luadh i pjellorisë
nuset tuaja erë ftoi
gjakun e kuq ta rinojnë
Kosovë
dashuria jonë e përjetshme

Plagët

mbi plagët e jetës mundimshëm
bregun e lumturisë pushtuan
lumturi e braktisur
prapa mjegullës fsheh

shikimet e tyre ngrinë
në agimin e parë
gjethe ftoi
shpërfillur mbi lëndinë
rrezet e para të mëngjesit
lotin e vesës shkrinë

butësisht heshtën ata
vite me radhë
me plagët e dashurisë në gjoks
nuk u ankuan
aromën e takimit të parë
nuk e harruan

Smirëzi

mirë
ta zëmë
sikur ata u ndanë
u larguan
dhe
çka përfitoi bota
nga vrasja e dashurisë
veç
shamisë së zisë

mbi fatkeqësinë e tjetrit
mos ndieni kënaqësi
ju të mallkuar
ju smirëzi

Brengë e vjetër

nga shpirti ynë
sikur u shkëput diçka
mungesën do ta ndjejmë gjatë
hije e djegur
brengë e vjetër
një jetë
kërkuan njeri tjetrin
për të nxjerrë nga thellësi e shpirtit
mllefin e fatit të djegur

Dehje

në rrugët e pafundme
joshur
nga loja e dashurisë
si të parët tanë dikur
dehur nga ndjenjat
e fshehura të djalërisë

arsyeja mbi ndjenjat
të triumfojë
dashurinë e sinqertë mos fshihni
krejt njerëzishëm
në rrugën e madhe të kësaj bote
ndjenjat e dehura
mos i vini në lojë

Zgjohu

tund dheun
forcërisht ngrihu nga fundi i botës
merr rrugë
njeriun tako
njeriun dashuro
me njeriun e sinqertë
në rrugët e jetës
udhëto

Për ty

rrugët e jetës preva në mes
këngën e pakënduar
rifillova
me zërin që gumëzhin
vargjet e pathëna
për ty
nuk shteruan
eh
shteruan mushkërinë

mbi fatin tënd të tjerët
dhunshëm diktuan kursin e rrugëtimit
dashuri e shpirtit
në rrugëtim
jetë në flakë përcëlluar
jetë në blozë e tym
pa ty
kohë në rinumërim

Shpërthim

mitin e robërisë shpirtërore vranë
gjithë ajo peshë padrejtësisht
bartur përdhunshëm në kohë
a thua iku
vrasësi mitik i këngës lirike
shpërthe
shpërthe ndjenjash ti
moj mike

urojmë që koha të shërojë
plagët e trupit
më shumë
plagët e shpirtit

Fyelli

për një tingull dashurie
plasën mushkëritë
plagët e zemrës kërkojnë shërim
melodi e thjeshtë

Kosovë
fyellin e dashurisë ta grabitën
nga Mollë e Kuqe
tek Guri i Shpuem
ditën të qanë natën të shitën
tingull i fyellit të grabitur
fishkëllimë
Kosovë
dashurinë për ty nuk e tjetërsuam
nuk e shitem
me këngën e dashurisë në gji
me ty e për ty
jetuam

Sirenë

fatin joshës kërkojmë
mbi krahët e këngës
butësisht shaluar
këngën për ty kërkuam
sykaltër si deti
Sirenë
kot nuk të pagëzuam

mes trëndafilash përkundë
këngë në grykë mbetë
djep i ninullave plot
me dashuri
e
jetë

THYRJET NË PASQYRË

Papandehur

tek lulishtja të takova
papandehur
mes hamendjeve s’u pendova
shtanga
desha
por dot
nuk u largova

mes lulesh
aromën e një luleje
mora

Kujtime

mbi sipërfaqen kaltëroshe
si në pasqyrë
dukej portreti yt
kujtime të largëta
nga dallgët e jetës përmbytë

tani
ikën ato kohë
kur në bregun e lumit
portreti yt
buzëqeshje dhuronte
kujtime sa një det
kush nuk të adhuronte
kujtime
që përjetësisht
koha nuk i vret

Moshë e tretë

në rrudhat e jetës humbë e tretë
të rrudhur e të zënë ngushtë
para vetes
s'kemi nga ikim
janë
ligjet e jetës

moshë e rrudhur
moshë e tkurrur
në kohë
e me kohë
dashuri dhuroni
për botën flakëmadhe
kujtoni
mos harroni
moshën me halle

Thyerjet

plagë të pashëruar
thyerje të pashtruara
peizazhe të lënduara
nga thyerjet
që rëndojnë

rëndojnë si guri
në zemër të malit
thyerje e zemrës së vashës
e zemrës së djalit
nga shkëndijat e para
të mallit

Përjetime

dashurinë skofiare
kush e ndien
më shumë

me të përjetuarit e veçantë
të bukurës së dheut
kush i këndon

me gjuhën e vet
më bukur se poeti
asaj
kush i flet

Muzat

muzat e mesnatës me joshje
në befasi i zura
më luten që t'i falja
jo
nuk i fala
në poezi i vura

ndjekja kishte filluar që moti
vërdallë të vinin mendtë e kokës
i zuri ai që ishte më i zoti
në gjirin e tokës
ku bima kokën kishte nxjerrë
idil e muzës
që nuk shterë

Fitores

në rrethim
shtrënguar
një rrethim krejt i errët
që pretendonte ta ndante
nga të jetuarit e vet

ajo e kuptoi rrethimin
qeshi
nuk bëri vaj
e vrau hilen prapanike
me buzëqeshje e saj

Pa dashje

pa dashje moj zogëz
të fyeva
të lëndova
i gjalli edhe mund të gabojë
që moti s'kam fyer askënd
sonte
do ngrysem me faj

ndihem i lodhur
i trazuar
diçka m'i gërryen mushkëritë
mbase fyerja që të kam bërë
ëh
të mos ishim takuar atë ditë
pa dashje

Syzeza

mbi vegje mbeti syzeza
fatziun duke e qarë
fijet e pëlhurës u këputën
në rrugën e shpresës së humbur
ëndrrash kallë

pëlhurë e bardhë
dërrasë e vekut
kthyer në dërrasë varri

Syzeza
në botën përtej lotit
të kërkojë fatin e saj
jeta ka edhe lumturi
nuk ka vetëm vaj
pëlhurë e kuqe
pëlhurë e bardhë

EPIKË E PËRFLAKUR

Çiltërsi

kambanat po bien
për një kurorëzim dashurie
botën e madhe po e zgjojnë
nga gjumi i rëndë

qyteti po kumbon
tek altari
çiltërsisht para dashurisë
përkulet njerëzia
dashuri e hedhur në altar
dëshmitarët duartrokasin
çiltërsi valë
kambanat zinë
po vrasin

Portret

në galerinë e qytetit tim
atë ditë
mungonte portreti yt
kryq e tërthorë i rashë gjithandej
askush s'të ngjante
as në portret

fytyrë zbehur ika nga aty
me frymën e këputur
në vesh
zanat butësisht më thanë
o njeri i mirë
portreti portretit
nuk i ngjan

Shkëlqimi që vret

se do të vriste shkëlqimi i vet
e kisha vënë re
kaherë

ti
vesë e bardhë
yshtur pas hënës së kuqe
mes yjesh
u fute në garë
ndjenja e krenarisë në fluturim
në qiellin tënd
mospërfillëse
të vrau shkëlqimi yt
e ne
na plasën sytë

Rimat

të bukurat rima në vargje
të bukurat nota në harqe
të bukurat peizazhe në natyrë
të bukurat zana ndër male
asgjë s’paska
të përkryer

rimat
na pritën e na përcollën
shi dashurie në jetën tonë
sollën
në kopshtin e trëndafilave
të prushtë
dashuri mbollën

Një tufë me lule

zhytur në botën e fantazisë
në dorë po mbante
bastunin
një tufë me lule mbështjellë
dhe peshën e pleqërisë

ndër mote
këngët e pathëna të dashurisë
nuk u thanë
kishin punë të tjera etërit tanë
lirikat e buta
luadheve me lule
i mbollën
për ne
i lanë

Notat e melodisë

notat e shkapërderdhura të melodisë
nuk i gënjeva dot
lirikat në gjumë nuk i vura
as sot

në motin e ndërrimit të hënës
fytyrëmadhe sa një bukë
foshnja
në gjirin e nënës strukë
në gjirin e nënës
si në gjirin e atdheut
prej damarëve të gjakut të saj
buroi jeta
kënga
përjetësia
burojë
dashuria hyjnore

Më shumë dashuri

mos qani më shumë se ç’duhet
këndoni më shumë
mos urreni ligjet e jetës
dashuroni më shumë

pas shpine
mos shani të bukuren e dheut
lirikat flasin më shumë
këngët të mos i vrasim
botën e madhe ta thërrasim
për paqe
e më shumë dashuri
pas shpine mos më shaj
as ti

Trazim

me ndërgjegje të trazuar
kaq herë kam provuar
sinqerisht
mendjen kam vrarë
netëve të gjata
neveritë që si mbanë letra
mendimet m‘i kanë ndrydhë
mbi mundësitë e mia
nuk dola dot

trazim i bartur nga dje
me buzëqeshje ironike
sot
si dhuratë e ftohtë
edhe këtë natë
ikja jote moj mike
e rëndë
si ngulje thike

LIRIKË SHPIRTËRORE

Goditje

vështrimi i saj më goditi
me erë
puhizë e aromë
frymëmarrja
më tradhtoi

u hamenda
s'u përmbajta
nga urrejtja apo dashuria
goditje e fatit të lig
mbase
nga të dyja

Nëpër kohë

si në ëndërr kaluan
nëpër kohë
vitet

si një patkua kali
varur mbi derën e vjetër
mbetën
kujtimet

fat i varur në gozhdë
jetë e mbushur me shpresë
njerëz
lini gjurmët nëpër kohë
se koha ikën
kujtimet
tretën

Kaltërsi

kaltërsi e syrit tënd
si kaltërsi deti
do të futem në thellësi
të vërtetën
për ta gjetur

sy
kaltër
sy
patrembur moj zanë
bjeri rrotull botës së dashurisë
bjeri
anë e mbanë

Këmbëngulje

nuk u bëre kurrë një me qetësinë
jeta e lidhur me këto male
madhështi shpirtërore
që të ngacmon
për të mësuar
diçka për të gjallët
diçka për të vdekurit
e diçka
për ata që do linden
një ditë

me këmbëngulje kërkojë
kënga
të mos ndalojë

Këngë

këngë e vaj
ekuacion me shumë të panjohura
dashuri falni
për pëllumbat e qiellit tonë
në fluturim
rënë

kënga për ju gjithmonë
u këndoftë
kënga për ju
kurrë
mos u shoftë

Fali

çapkënët të “shanë” ty
të “shanë”
faqepjeshkë të thanë
ti u skuqe
buzëkuqe
moshë e re
moshë pa mëkate
moshë me huqe

fali
të padjallëzuara ka sharjet
rinia
fali e lehtësuar të jesh
mes shoqesh më e bukura
ti
faqepjeshkë

Portreti në kornizë

dikur moti
piktorë të kohës antike
joshje
frymëzim
idil
sakrificë këmbëngulëse
bukuri mitike

koha të solli nën sqetull
Monalizë moj mike
gënjeshtër apo
realitet
buzëqeshja jote
ndryrë në portret

brenda kornizës në shekuj
histori e pa zbërthyer e artit
kjo mjeshtrin e penës së vjetër
varur në maje të gozhdës
si testamenti
në letër

Çmallje

pusi i zura
shtegut të retrospektivës
u çmalla në soditje
o kohë e pa djallëzuar
ndjenja të papërsëritshme
ti ike

çmallje me portretin tënd
zana të shitoftë
ti
kohë në ikje

Dashurisë i kënduan

i kënduan
faraonë
perandorë
mbretër e filozofë
për ty ngritën tempuj
e nuk të përjetësuan dot

prapë dashurisë do t'i këndojnë
si dje
sot e mot
njerëzit që dashurojnë
rimën e djalërisë kanë në gji
muzë me frymëmbushje
o njerëz të botës humane
këndoni
këngën e madhe

FALNI LIRIKAT

Një mall

më zgjoi çuditërisht një mall
magjepsur nga shkëlqimi i rremë
qiellin frikshëm shikova
ngrohtësinë e trupit të saj
në shtratin e ëndrrave të mia
e ndjeva
jo
s‘e takova

një zhurmë më lehtësoi mendimin
trajektore replikash
në dilemë
për fjollat e shkrira të borës
në sapofillim të dimrit
si ëndrrat tretur
tek streha ime
nën peshën e mallit të vjetër

Lirikë

dashuri
herë tragjike
herë lirike
kush troket në derën e
këngëve të mia
nga plagët e jetës lënë
në rrugët e saja të gjata
mendim i pathënë

lirikat e mia
lagur me ujë
lagur me djersë
lagur me verë
lagur me vesë
thjeshtësi e fjalës
kuptimin se humbe kurrë
dashuro jetën
rini e vendit tim

Ëndërr e vjetër

një trazim
në ndërrimin e stinës së vonë
si nëpër mjegull
mbi aeroportin e Prishtinës së vjetër
ateroi
ëndrra jonë e djegur

baladë e lashtë e lotëve të lëndinës
prapë lot
mbi aeroportin e Prishtinës

në shtegun e gjatë
rrugët e mallit të kurbetçinjve
as sot
zanat e malit
nuk po i lënë rehat
prapë
lot

Rënie

bora ra nga maja e malit
mbi faqe
gjurmët e rrokullisjes së lotit të kripur
mbetën
si gjurmët
e plagës së vjetër

loti i rënë nga gjethi i lisit
si rënia e Sizifit
e domosdoshme mbase
borë e bardhë rënë
si bardhësi plisi
gjurmë të pashlyera dashurie
përgjithmonë
rënë e
lënë

Befasisht

pak kohë para se ta tradhtonte
befasisht
i tha ajo
të dashuroj
të vetmen gjë që nuk e priste
nga jeta
ishte tradhtia

a thua erdhi ora
e qetësisë shpirtërore
një orë para se ta tradhtonte
ajo
i tha
të dashuroj

vallë
kush s'më thotë
të jetë kaq i cekët lumi
mes dashurisë
e tradhtisë

Trokita

ndrojtur trokita
në portën e kujtimeve të largëta
testamentin e mallit të parë
në kalanë e lashtë
hipotekë lënë
për ta marrë

barrë e një kohe tjetër
padrejtësisht rëndove
plagët
e kohës së vjetër
në dyert e ndërgjegjes trokasim
të vërtetën për ta gjetur
ëh
sa jemi humbur
sa jemi tretur

Ndryshku

nën kangjellat e hekurt
pranë dritares
një zemër ndryrë nën kraharorë
ndryshku e hëngri
ndryshk ky
tinëzisht i vënë nga një dorë

ti kohë e ndryshkur në ikje
domosdoshmërish dënuar
nën kangjellat e dritares moj mike
po marrin jetë
trëndafilat
e kohës së vonuar

ATJE KU NUK BIE BORA

Vargjet mos m'i prekni

mos më zhvishni nga gjërat që më rrethojnë
s'ka gjë
kush të dojë të më shajë
kush të më lavdërojë
unë nuk ndjehem i vrarë

vargjet
batutat
veset
lirikat
mos m'i prekni
janë petkat e mia që më ngrohin
është godina e shpirtit tim
që më mbron
nga furtuna e hidhëruar
netëve të gjata pa gjumë

me peshën e lapsit në dorë
kam shqyer heshtjen e natës së vonë
figurave jetë për t'ju dhënë
lini ato të marrin udhë
se malli me dogj për udhët
e atdheut tim
lini

Harrimi

dera e vjetër prej druri
nuk po troket më
zilja e telefoni nuk cingëron
letra ka kohë që s'kam marrë
as në E-mail

përmallshëm një pështjellim
pikëtakimin diku
në fushat e atlasit tim
ku meridianët kryqëzohen
një numër mungon
mungon
ti

ti
që zgjoheshe para agimit
peng i kohës mbetur
në gojën e harrimit

Pa pritur

erdhe në galerinë time
pa pritur
para veprave pamore
në gjunjë rënë
në shumëkuptimësinë e tyre
butësisht
diçka kërkove

portretet u asfiksuan papritur
pikturave memece
zjarrmia u ra mbi ballë
nga valë e dashurisë
së mallit të parë
lotët rrodhen mallëngjyeshëm
mbi faqe
të portretit të saj
shtangur vizitorët
portreti po qanë

Gjallë

në gjirin e llogarive të vonuara
mos humbisni kohë
bëhuni të gjallë
ngrohtësi
këngës për t'i dhënë

pa dyshim
ngrohtësinë e gjirit tënd
ngrohtësinë që na dhurove ti
nënë

Hiri

thëngjijtë e fjetur nën hirin me ngjyrë
i trazoje ti ngadalë
si flokun tënd dikur në pasqyrë
me ndjenjën e dashurisë së vaktë
trazim i rindezur thëngjijsh

ngjyrë e prushtë me hi mbuluar
nga ai zjarr i madh
në oxhakun e vjetër dikur
nën hi
mbeti nënshtruar
zjarr i dashurisë së djegur
nën hirin e fjetur

ti varg i pashkruar
i një kohe tjetër
peng mbetur

E pa thënë

kush guxon të trazojë
lumin e mendimeve të mia
nga orët e liga nuk mora gjë
nga buzëqeshja jote
sinqerisht
plagët miklova

nga urrejtja për atë kohë
deri tek dashuria
e fshehur për ty
sot
ka diçka çudibërëse
që e mbaj peng në gji
e pa thënë në kohë mbet
kënga e dashurisë
për ty
tretë

Sonte

sonte më duhet dikush
sonte më mungon dikush
sonte më bezdis dikush
sonte më frymëzon dikush

sonte
si në përrallë më vjen malli
për kohën e largët
që u mbyt përfundimisht
në detin tonë të kaltër

sonte
valët e detit janë trazuar
nga pamundësia e kthimit
mbi retë e bardha shaluar
në fundin e stinës së dimrit
me huqe lazdruar

sonte
unë dhe deti po gjëmojmë
valët në kacafytje
në shenjë xhelozie
sonte
namin po bëjnë

Këtë natë

kalorës
mbi shpinë i kam hipur kësaj nate
deri me të zbardhur do ta shaloj
mbase do ta arrij cakun
kohën e largët ta afroj

unë kalorësi yt
unë jam
sa herë kam fluturuar
mbi re të bardha e të zeza
unë jam fajtori
nëse sonte
të zë lemza

nga joshjet e kohës së lazdruar
edhe këtë natë mos më shaj
retrospektivë e vrarë pa fajin tonë
nga kujtimet e fundit
të asaj nate
nate
të vonë

sonte me buzët varë
do ta lë në rrugë
vargun kujdestar
duke të kërkuar mes yjesh
mes yjesh me zjarr

ti shelgu pranë portës
me gjethet varë

Përplot një jetë

pse për ty
kënga ime pashpjegueshëm vonoi
kaq rëndë kush e vrau
këngën tonë

ëndrrat tona rinore
kaq pamëshirshëm
kush i lëndoi
tani
gjoksi dhe kënga në shpërthim
nxorën vrerin e kohës së vrarë
si shtëllungën me tym
mbase nuk të vjen keq të të them
edhe pse kaq vonë
e dua qiellin
ku ti fluturon

AUTORË TË SAKRIFIKUAR

Me thinja

kohë në ndrydhje
thinjat rënë si bora mbi mal
bukurinë e dikurshme
nuk ta fshehin
nuk ta vrasin
as malit
as ty

me instinktin e mbrojtjes
barrikadë mes vargjesh kam vënë
si në istikame
nga martirizimi i pleqërisë
ti kohë në ikje
që butësisht kalon
thinja që diçka flasin
që më shumë thonë
ti kohë e thinjur
e stinës së vonë
lojë e dikurshme
ndalur
në një stacion

Kot u mundova

konstatimi se disa gjëra
nuk mund t’i ndjesh
nuk mund t’i ndalesh
nuk mund t’i kuptosh
nuk mund t’i përshkruash
ndryshe
veç siç janë
fatmirësisht
më doli i saktë

dashuri intriguesit
nuk duhet t’i falesh

Pyetje

Gjeneral nuk kishim parë
ushtarë të sprovuar
në fushën e përgjakur të dashurisë
po

ushtarë pa Gjeneral
pyetje në kohën e gabuar
që romantikën prishin
ushtarë rënë në pusi të dashurisë
me këmishën e grisur lidhnin
plagët e saj

në përpjekje për të shëruar
shpirtin e butë
në butësinë e shikimit
humbur e trazuar
flakën e dashurisë
ndezur
kishin harruar

Të kërkova

me një tabor hijesh të shpartalluara
të kërkova
ti gjurmëhumbura e zanuar
nuk erdhe as sot

s'kisha shumë për të të thënë
veç se dy fjalë
ti Zanë e zanuar
më thuaj

atë ditë kur admirimi të kalon në urrejtje
më thuaj
nëse intrigat kanë zënë vendin e bujarisë
më thuaj
mos të gënjehemi mes vete
më thuaj me kohë
pas kohe
jo

Porta e dashurisë

kokën kishte mbështetur
në gjoksin e fatit
në dremitje të dy
fati dhe ajo

të humbur që moti në soditje
rrugëve të ndjenjave lajthitur
me shpresa zhgënjimi nën sqetull
në kërkim të një strehe tjetër
trokit fuqishëm
tek portën e dashurisë së vjetër
në tentim për të kthyer
motet e mira
për të kthyer
kujtimet e dëlira
ti
ishe më e mira

Rexha i nënës
(O mor gjok t'u këputeshin jelat...)

mes shqelmave të legjendës
dhe mistifikimit ndër shekuj
kënga për dhembjen
mbi fatin tragjik
u mitizua

mes tragjedisë së mitizuar
dhe ndjenjës për të
një këngë elegjie
mori udhë nëpër shekuj
shtigjeve të jetës ngatërruar
dhe prapë u këndua
dhimbja nuk pushoi
për trimin
dhe nusen
e pafat

më barrën e dhembjes
të vdekjeve tragjike mbi shpinë
populli im
kaluar shalove nëpër kohë
e koha nuk të zhveshi nga mitizimi
i vuajtjes

zgjohu Rexha i nënës
e dil

të shtegu i lamës
se dasmorët po vijnë
po të sjellin nusen
dasmorët që rrugëtuan njëqind vjet
po të sjellin nusen
dhe melodinë

Univers
(F.Grajçevcit)

përditë po i zvogëlojmë borxhet
përball jetës sonë të varfër
shprehimisht
vitet që na takojnë po zvogëlohen
numra në rënie
shtrëngatat ziliqare na kanë rrethuar

arkeologu pranë ashtit fosil
gojëhapur e hutuar mbeti
retë ngarkuar plot me shi
ulur por si kësulë e bardhë
mbi majat e larta të Golashit
atje ku flamuri i ëndrrave tuaja
zhurmshëm po valon

me zvogëlimin e viteve
dhe borxhit ndaj jetës
pengu i borxhit një ditë
mbetur fashitur brenda vetes
të porta me rrapëllima do na trokasë
për të marrë hakun e së vërtetës
do t'na thërras
kush (s)më thotë
e kemi zvogëluar borxhin
për vëllain e motrës
për birin e tokës

për Fazliun e nënëlokes
që dashuri i fali atdheut
i fali jetës
i fali tokës

Pa emër

zjarr i prushtë dhe hekur i farkuar
nuk iu ndanë tërë jetën
me dorë rrahu hekurin e skuqur
me hekur davariti
hallet e jetës
shprushur

e habitshme
botë me hile
si nuk i ngritën dashurisë një shtatore
ku do të gjunjëzoheshin
në shenjë pendimi
vrasësit e saj

Më lini

mos më qorto
pse këngët i kam të tilla
pse futem skutave e shpellave atje thellë
ku deti të fundos e vala nuk të nxjerr
ku shtrihet terri e mëria
ku fshihet përçmimi dhe ironia
mos më pyesni
pse gërmoj atje

dua të futem atje thellë
ku në pasqyrën e liqenit shikohen zanat
dua t'i prishi kurthet
ku rrjetin ngrehin merimangat
dua t'i futem atdheut në kërthizë
atje
ku fshihen thellë
këngët e dashurisë

HIJET E SHPIRTIT

Nënë

kush më ëmbël fjalën thotë
bukën e ngrohtë kush na e bënë
kush na përkëdhel me dorën e vet
me zemrën valë
kush na uron rrugën e mbarë
kush rron me kujtimin për ne
nënë
sa shpirtmadhe je

Për nënën

në kujtim të pritjeve të saja të gjata
kur kthehesha
nga rruga
nga shkolla
nga burgu
nga mërgimi ...

tani kush do të më presë
ajo nuk është më
nënë
veç atë dhe tokën shqiptare
kam thirrur

nënë
simbol i pjellorisë
nën
rrënja e Shqipërisë

Të urtës nënë

lëvizte kujdesshëm me hapat e lehtë
në oborrin e lulëzuar të shtëpisë
dorën vënë mbi ballë
e në soditje
me aritmi zemre
në pritje
të kthimit të bijve të saj

atje fshehur
përtej avllisë
po fshinte lotin e saj
me cepin e vjetër të shamisë
nën strehën e pritjes
me zemër të djegur
pritje

ëh
ato pritje të gjata
në rrugëtim na zu nata
të dy palët
pa gjumë
ne
dhe nënat që i duam shumë
të urtat nëna
për ju
s'do shterojë kënga

Një jetë
(bashkëshortes time)

dorë e saj shtrirë lehtë
mbi rrudhat e ballit tim

dinjitetshëm
katrahurat e kohës përballoi
bartur padrejtësisht mbi shpinë
vuajtjet
dyfish i përjetoi
si grua dhe si nënë
me atë në krah ndihem nderuar
që barti mbi supe
barrët e jetës së rëndë

në kraharorin tim
nga zjarrmia kallë
jetë me peripeci
jetë valë
jetë si në ëndërr
jetë zhgjëndërr
jetë si në përrallë
jetë dhimbjesh e plot mall

edhe një jetë sikur ta kisha
e kush jetën nuk do ta dëshironte
dorë e saj mbi ballin tim
kurrë
nuk do të më lëndonte

Gjithmonë

gjithmonë do të kthehem tek ti
edhe pas vdekjes
toka brenda nuk do më lërë të qetë
nuk e di
nëse unë ju mungoj
aq sa më mungoni ju mua
nuk e di
nëse më doni
aq sa unë ju dua
nuk e di

peizazhe të atdheut
më çoni shpirtin peshë
më trazoni kaq shumë
unë shpirttrazuar
si hije
fundosur në humbëtirat e kohës
as zgjuar
as në gjumë

Kohë

na duhet kohë
për të sjellë në kala
nga fundi i botës Doruntinën
vëllai ngritur nga varri
erë dheu po vinte
po vinte erë bari
prej kohësh
vëlla e motër
degdisur e djegur malli

në kërkim të pafajësisë
u ngritëm edhe nga fundi i dheut
besën e dhënë
peng nuk e lamë
dashurinë për motrat e sollëm
në gjirin e këngës së lashtë
si në ëndërr
erdhëm edhe nga bota tjetër
fluturim me atin e bardhë
përballë motrës
fjalën e dhënë
peng nuk e lamë

Hyrje në pranverë
(kushtuar demonstratave të viti ’81)

pranë dritares sy hapur
nga maja e pemës
u ngritën zogjtë në fluturim
me krihet e butë
borën shkunden
pranvera po vjen
ma në fund
edhe në qytetin tim

po
po vjen marsi i trëndafilave
afshi i ngrohtë tokën puthiti
një lirikë
për bisqet e pemës
po ndihet frymëmarrja e blerimit
ngrohtësi e stinës ripërtëritëse
stinë e lulëkuqeve
të marsit të parë

Prishtinë kujto me dashuri
kujto
stinën e trëndafilave të kuq lirie
Prishtinë ata ishin të rinj
si trëndafilat
që ranë në pranverën e vitit ‘81

Mure

në kërkim të një ndarjeje të përjetshme
mure të larta kishte ngritur
dikush
me gurët e lashtësisë
në qepallat e vashës
pamëshirshëm kishin goditur
këngën e parë të dashurisë
për ta vrarë atë
sot e dje
pa llogaridhënie
në kohë

enigmë e pazbërthyer
mbështjellë me vellon e verdhë
muret e ndarjes
ngulur kaq thellë
në zemrat rinore
mos
urrejtje mos mbjell

Dashuri

njerëzinë dashuronte
lum e krua harronte
pranë burimit
zemër trazuar ngrihej si n’ jermi
etje kishte
kishte uri
për botën e dashurisë njerëzore
pas muzave prehur
pas huqeve dehur
vetën kishte lënë pas dore
nuk dinte për urrejtje
ai dinte
vetëm për dashuri

Porta ime e lashtë

ëh ...
shumë herë jemi ndarë
e vetëm të kam lënë
vetëm fillikat
në rrugët e fatit e të fatkeqësisë
në rrugën e gjatë

si thika në zemër
me shpirtin nën dhëmbë
fat i lidhur me zinxhirë
me mendjen tek ty
e kam pasur rëndë
e kam pasur vështirë

po kthehem ngadalë
tani
nga anët e botës rrugëhumbur
tek porta e atdheut
i heshtur
do trokas i ndruajtur
në dyert e nisjes
nga ditët e largëta të braktisjes

po kthehem
unë
biri yt i tretur
flokëbardhë e i mplakur

po kthehem tek pragu yt
me lëmshin e mbledhur në grykë

ZANORET E BARDHA

Përzierje

sonte do iki në kahun tjetër
nga andej
ku shkon njerëzia
me ndjenjat e përziera
do marrë rrugë

kisha menduar të largohem që moti
nga pikënisja ime e parë
me mesazhin e vonuar të pritjes
po bëhem i gjallë
mes ndjenjash të përziera
për ta gjetur të vërtetën
mbi dashurinë dhe urrejtjen
kufi të ligj
që vetes i vumë
net të tëra mbetur
pa gjumë

Çuditërisht

me dashje do thosha diçka
sikur ta gjej atë
që të tjerët nuk e kanë thënë

çuditërisht
nuk kishte mbetur as edhe një pëllëmbë vend
rrugën kishin zënë thashethemexhinjtë
mbi atë që nuk shkruhet
e që nuk thuhet

çuditërisht më kishte shtënë forca
e muzës së parë
që u përmbyll me një zanore dashurie
prapë
të njëjtit njerëz
gjëra të njëjta po thonë
për një botë të tërë keq po flasin

çuditërisht
vetëm ti
ke diçka që të tjerëve u mungon
qartësia e gjuhës me të cilën flet
guximi për t'u thënë gjërave
në emër të vet

Kthehu

kthehu
të të përqafoj së bashku me lumturinë
kthehu
veç edhe një herë
kthehu

në arkën ku kujtimi ndryrë mbeti
ku dikur u mbyll ajo derë
pengu i dashurisë u vyshk
si gjethe e verdhë
rrahur nga erërat
në heshtje degdisur
kthehu

jeta të mori nën sqetull
pluhurin e kohës davariti
kthehu tek pragu i këngës së vjetër
tek ajo strehë
ku së pari hodhe lirshëm
këmbën e vockël mbi dhe
kthehu

Shtegtim

kokën kam vënë në prehrin e lashtësisë
udhëtoj pafundësisht në oazën shqiptare
ku prek trëndafilin me vesë
me gishtërinjtë që dridhja i tradhton
lot e vesë u bënë bashkë
dhimbja që më shpon thellë
thellë
deri në asht

lojërat e fëmijërisë shqip gumëzhijnë
në kujtimet e mia
eh ç'mu këput diçka e krisi
në gjoksi tim
diçka si degë lisi
që bie me dhimbje e rrapëllimë
e rëndon si guri
mbi varrin tim ku dheu
dheu
vend nuk zuri

plagë e përjetshme në kraharor
mbeti
mbeti mbi gjoks një dorë
një dorë e ngrohtë kujtimesh
në rrugët e pafundme shtegtimesh

Sprovë

mes sprovash të vështira
rrugët e jetës na kalisin
mesazhin e dashurisë përhapni gjithandej
maje kokës mbani të bardhë plisin
mos u joshni pas fijeve të lakmisë
mos e ligështoni fisin
arbëror

ai
me dorën e vet burrërore
mbolli fidanin e parë
në kopshtin e dashurisë
në vatrën e prushtë shqiptare

atdhe
me besën e dhënë për ty
për besën u dogjëm
fjalët mbrapsht s'i hoqëm
deri në amshim
për ty dhurojmë dashuri

Nuk erdha

unë nuk erdha tek ty
me dashje
pritjen ta bëra copa- copa

ti do mendoje mbase
ja
erdhi ky për të kërkuar diçka
jo
parimisht
në jetë
kurrë nuk kam kërkuar gjë
unin tim në lojë s'e kam vënë
as para teje
as para motit
as para zotit
nënshtruar para fatit nuk jam
nuk erdha
e nuk do të vij
me dashje
pritjen do ta vë në çmendi

Të gjallë

pas kaq vitesh papritur
ti
sërish shfaqesh në ëndrrat e kopshtit tim

ëh
të gjallë e të patretur
dhembjet e fashitura m'i ngacmove
të humbur e të pagjetur
strehëve të këngëve të harrimit
nën çatinë e shpirtit tim
të pata fshehur diku
koha kishte ngrënë kujtimet
si ndryshku
rimat e këngës sonë të kahershme
që moti nuk janë trazuar
këngët
që koha s'i vyshku

a thua do të ketë nota që artikulojnë melodinë
në gojën e pranverës së parë
kur ti ike
këngën e lë vetëm
e nuk u bëre më e gjallë
si kujtim
lulet mbi tryezë mbeten
me shijen e aromës së parë
ëh
të gjallë

LIRIKAT E FJETURA

Si trëndafili

si për habi
edhe këtë ditë
prapë
ajo u zgjua kaq herët
mes nesh ajo vetë
më e bukur se trëndafili
që jeton
vetëm një mëngjes

në kopshtin e dashurisë
ti lulja me vesë
petalet për dhe kishin rënë
luteni
mos i shkelni
mos i shkelni ato më këmbë

Përjetësi

vështrimin përtej detit kishte hedhur
rrugë e shkretë në mes këputur
rrugë
përgjysmë mbetur

ajo po priste trimin
atje
ku pinte ujë burimi
rrugë
ngatërruar mes ëndrrash të vrara
sa s'plasi prej trishtimi
në prehrin e legjendave
trimi i saj kishte fjetur
sykaltër si deti
sy kaltër si lumi
në gjirin e këngës përjetësisht
trimin e saj
e kishte zënë gjumi

Çaste

me gjithë shpirt
do të lutem për ty
mbi gjurmët e lashtësisë
një shenjë
mos të lëndohet askush

atje ku i kishim caktuar
shtratin gurit
atje ku fle i qetë shpirti im
për pak çaste
në këmbë qëndrova
si perëndinë
gurët e atdheut
zanat e vendit tim
shpirtërisht adhurova

Përtej pritjes

sonte nuk do të flas më shumë
sonte do të pres në shkujdesje
sonte do rri pa gjumë
deri sa të zbardhë
e lumja ditë

në pritje të ngadhënjimit tënd
vendi s'po më mban
nuk do bëj gjumë
as net të tjera
deri sa ti nuk i buzëqesh jetës
deri sa edhe për ty
nuk do të del pranvera
pritje
përtej pritjes
ti hënë e natës
e diell i ditës

Përditë

përditë e ngapak po zvogëlohen
hapësirat e kohës së butë
ashpërsi e mortit
matemi me hijet
mbi lëndinën e lotëve
burrëri e hequr në kandar
mes kockash shkapërderdhë
lulet që u thanë nga loti
për një pikë ujë
mbi plojën e verdhë
vetëm ti
jetë dhe dashuri sjellë

një ditë
do rinohen ato
atë ditë kur tek kjo derë
do bëhet i zoti
do thahet loti
ndër mote derdhë

Malli

bashkudhëtojmë rrugëve të qytetit tonë
kalldrëme që i kemi shkelur dikur
së bashku me këmbë
si në ëndërr i pashë
i pashë
mbrëmë

këngë e vjetër
që nxjerr vrerin e heshtjes
mbi melodinë e fatit të djegur
po
si në ëndërr
ti fluturon mbi re të bardha
e njerëzishme hijelehtë
butësi shpirtërore mes yjesh
kohë e butë në davaritje
që mallin nuk e tret
ti drenusha e malit
ti
e bukura e dheut

Orë e vonë

hyre në portën e shpirtit tim
e ndrojtur
në këto orë të vona

ti
hije e pambrojtur faqe murit
në pafajësinë tënde degdisur
kush të goditi kaq padrejtësisht
këtë damkë kaq të zezë
kush ia dha
ëndrrës sate të brishtë

ti
gërvisht të kaluarën tonë
me shpresa të këputura në mes
me ritmin e orës së vonë
ku akrepi ndaloi
me kujtimin e saj tretur
mbeti ndalë përherë
akrepi i orës së vjetër

ti
pranë dritares së vogël
ku qiriri flakët lëkund në përpëlitje
butësisht trazojmë ëndrrat tona
të kohës së largët
që gjumin prishin

të kohës në kusuritje
ne dhe koha
të dy
në pritje

Nuk dua

nuk dua
që vargu im
në vete të bartë
peshën e shqetësimit

nuk dua të shprush
në ëndrrat e bukura të jetës sate
sylarushë

ylli yt vezullues të ndriçojë përherë
të rrugëtojë lirshëm hapësirave kaltëroshe
të shkëlqejë më shumë
ngase dëshiron

ti
më e bukura mes shoqesh
nga do që shkon
vetëm ti
para yllit të mëngjesit
me flokun e shkapërderdhur mbi gjoks
agon

Një ditë

një ditë shtatori të takova
atë ditë
ëhë
atë ditë

kujtimet fiksuan peizazhin e vonë
një ditë dhe një herë
në shtator dashurova
dhe një ditë tjetër
shumë më vonë
u ndeshëm prapë
nën strehën e vjetër të këngës sonë
u ndeshëm më kot
dhembshurisht
ishte tepër vonë

Lozonjare

vardisur pas këngës si sorkadhe
të bukurat lozonjare
në valle
ngjeshur në radhë
aritmi
në gjoksin e saj
me zemër të kuqe
ai po bëhej dhëndër
ajo nuse

lozonjare gushëkuqe
vallëzo
mos ndalo
rrugë të gjata ka jeta
jeta
ka rrugët e veta

Lulëbardha

as atëherë
ti nuk mbaje gërsheta
me flokun e zi mbi supe
mes qindra lulesh të gjeta
me ëndrrat e bukura na lidhi jeta

dhe ëndrrat i zuri mynxyra
enigmë e fatit pa zbërthyer mbeti
ndjesi e butë
e çiltër ishte rinia
as atëherë
ti nuk mbaje gërsheta
ku do varej dashuria

bengu i kohës që gërvisht
në kujtimet tona
kohë e vrazhdë
kohë që nuk ishte
nuk ishte
e jona

Dëshirë

nuk u duk
madje as sa për të dhënë kumtin
kokën kishte mbështetur në gjoksin e fatkeqësisë
për një kohë që ishte fishkur
për një kohë që nuk shpaguhej
për një kohë që nuk rikthehej

me atë pamje të veçantë
përzgjedhur sipas shijes së saj
dëshironte të mbetej e vetme
e vetme
si pranvera
pranverën për ta sfiduar

Si hëna

me dukjen e saj në horizontin e kuqërremtë
deri dje të kishim sharë
se na i mashtrove djemtë

si hënë e kuqe
moj nuse
përflakur në qetësinë e natës
pamje magjike
këto gjetje të rralla
si hëna
na erdhi nusja moj mike
imagjinatën e krijuesit
mori me vete
diku larg e davariti
diku larg e treti
kur hëna nga malet zbriti

Këngë skofiare

e buta kënga ime
me kë do flas unë këtë mesnatë
në konakun e zemrës sime
unë dhe ti
flasim me belhollën
me syzezën
me bjeshkën
me mollën
me lisat e gjatë
me kaltërsinë e lumit
së bashku
thyejmë heshtjen këtë natë

kënga ime
këngë e vjetër
këtë natë veç teje
nuk gjeta
prehje tjetër

Sorkadhes

të panumërt janë ata që të kënduan
kënga për ty kurrë nuk pushoi
syëmbël
sybutë
sinonim i urtësisë
pritë të vunë të rinjtë
verbuar nga bukuria jote
iu plasën mushkëritë

ti
e ndruajtur si gjithherë
nuk re në pusi të dashurisë
sorkadhe
kush vrau butësinë tënde
e vraftë dorë e motit
guri ballërrudhur shpuar
shpuar
nga kripa e loti

KUMBIM KËMBANASH

Ecje

me vështrimin e tretur larg
meditim në ecje
në rrugën e madhe të kësaj bote
me hapin tim të vendosur
shkeli me kujdes
mbi buzët e çara të tokës së plasaritur
dhembjet nuk dua t'ia rëndoj

ecje përpara
mbi buzët e çara
mbi buzët e vashës
mbi buzët e nuses
plasaritur
për një pikë dashurie
njerëzore
tokë e etur për një pikë uji
atje thellë
ku ka zënë fill fara
e dashurisë

me gjithë krenarinë e ecjeve
në rrugët vjeshtake
nën prizmin e syzeve të mbylltë
më i moshuar se dje
më i ri se sot
me ngrohtësi ylli
toka
nuk u ngop

Moshë dhe vite

ngarkuar mbi kurrizin tonë
vitet
përditë po rritën
po shtohen
në kujtesën tonë mbetën
bëmat që ikën
bëmat që kalëruam
kujtime prush
vite që nuk mund të peshohen
me halle mbushë

ishim të rinj
dhe
si të rinj që ishim
ëndrrash e ndjesish grisur
grisje me pahir
a do na falësh mëkatet
ti
o kohë e dëlirë

kohë që na iku si ndër duar
o zot
sa jemi penduar
përballje e plasur në sfondin e verdhë
tek lirikat e shumëkërkuar
lini hapur
mos e mbyllni atë derë

të kohës së bukur
rinore
që nuk rikthehet më
asnjëherë

Të kërkoj

duart më ranë copë duke gërmuar
në mos
në gjirin e tokës do të gjej ty
e ti
mbi dhe qenke
hyjni
kush s'të këndoi ty

në udhëkryqet e ngatërruara të jetës
mos humbni shpresat
narracion në ikonizim
hyjni kulti mbi dashurinë
ngritën njerëzia
ngritën
perëndinë e diellit
qiellin për ta mbarësuar
frymëmarrjen tokës
për t'ia shtuar

Të gjithë

në këtë jetë
të gjithë jemi sprovuar nga pak
djegur jemi
gëzuar
fyer e prekur
zhgënjyer e ngazëllyer
si valët e detit në përplasje
me buzë në vaj
një pikë loti
në cepin e syve të saj

dhe
prapë do të ecim bashkë
krah njëri- tjetrit
mbështetur fuqishëm
mbi të vërtetën
pika shiu në reshje
lotin ta kthejmë
në buzëqeshje

Kërkojë falje

kërkojë falje
bukën time të ngrohtë pranë oxhakut
dua ta ha rehat
nën çatinë e shtëpisë sime të lashtë
do pushoj i qetë

rrethuar me ëndrra të padjallëzuara
kërkojë falje
as kur jam zgjuar derën nuk ua hap
makthi i ligësive
ëndrrat m'i vret
dua të lirohem vet
dua të lirohem përfundimisht
nga njerëzit e ligj

sinqerisht kërkoj falje
nga ju o njerëz të mirë
nga ju o shokë
nga ju miq

Zvicër, 2013

Shënime për autorin

Mehmet Bislimi u lind më 24 mars 1958 në fshatin Prekaz të Epërm të Skenderajt. Shkollën fillore e mbaroi në vendlindje, kurse gjimnazin në Skenderaj. Në Universitetin e Prishtinës studioi shkencat natyrore. Në vitin 1981, për shkak të veprimtarisë atdhetare, arrestohet dhe dënohet me burg. Pas daljes nga burgu, më 1986, veprimtarinë kombëtare e vazhdoi në gjirin e LPK-së, ku pati detyra me përgjegjësi. Në vitin 1994, i përndjekur nga regjimi serb u strehua në Zvicër.

- Gjatë luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka bartur detyra me përgjegjësi.

Me krijimtari letrare ka filluar të merret që heret. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën ”Bota e re”, Prishtinë, 1986. Më vonë në revistën” Alternativa”, në Lubjanë, si dhe në disa numra të gazetës ”Rilindja”, që atë kohë botohej në Zvicër.

Për disa vite ka shkruar në organin e LPK-së “Zëri i Kosovës” që botohej në Zvicër dhe për të përkohshmen “Rruga jonë”- që dilte në Francë. Në të dy gazetat, për një kohë të gjatë, është paraqitur edhe me këndin e humorit me nofkat “Ngucakeqi” dhe “Gjembi”. Kohë pas kohe shkrimet e tij kanë gjetur vend edhe në gazetën “Epoka e re”, “Lajm”, “Kosova sot”, “Shekulli”

etj., si dhe shkrime të shumta publicistike në dhjetëra faqe elektronike. Krijimtaria e tij letrare përfshin shkrime publicistike, anekdota, humor, poezi, prozë, satirë si dhe mendime të urta popullore etj. Autori Bislimi është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, anëtar i krijuesve Shqiptarë në Zvicër dhe anëtar i Shoqatës së të persekutuarëve politik të Kosovës.

Deri më tani ka botuar këto libra:

1. ”Anekdota popullore dhe satira autoriale I”, Prishtinë 2002
2. ”Trëndafila maji” – poezi, Prishtinë 2002
3. ”Fjalë dhe gurë” – poezi, Prishtinë 2003
4. "Këtu i thonë Drenicë - Tahir Meha – monografi“, Prishtinë 2004
5. "Ironi e verdhë" - poezi, Prishtinë 2005
6. "Stinë e vonuar" - poezi, Prishtinë 2008
7. "Shkrime publicistike", Prishtinë 2009
8. "Anekdota popullore dhe satira autoriale II" - Prishtinë 2010
9. “Mehmet Delia - alias Mehmeti i Vogël”- monografi, Prishtinë 2011
10. “Shpirtndrituri”- poezi, Prishtinë 2012
11. “Burrëri e lagur” – poezi satirike, Prishtinë 2012
12 “ Lirikat e fjetura” – poezi, Prishtinë 2013, është libri i tij i radhës.

PËRMBAJTJA

LIRIKAT E FJETURA **2**

FJALA E REDAKTORIT **7**

NDJENJË E VAKËT **13**

ASAJ 14
ATË 15
NJË ËNDËRR 16
FOTOGRAFIA 17
KA VITE 18
PIKËLLIM 19
PRITJE 20
TA SHPËTOJMË DASHURINË 21
VITE 22

AROMË FTOI **23**

MUNGOJNË 24
PLAGËT 25
SMIRËZI 26
BRENGË E VJETËR 27
DEHJE 28
ZGJOHU 29
PËR TY 30
SHPËRTHIM 31
FYELLI 32
SIRENË 33

THYRJET NË PASQYRË **35**

PAPANDEHUR 36
KUJTIME 37

MOSHË E TRETË 38
THYERJET 39
PËRJETIME 40
MUZAT 41
FITORES 42
PA DASHJE 43
SYZEZA 44

EPIKË E PËRFLAKUR 45

ÇILTËRSI 46
PORTRET 47
SHKËLQIMI QË VRET 48
RIMAT 49
NJË TUFË ME LULE 50
NOTAT E MELODISË 51
MË SHUMË DASHURI 52
TRAZIM 53

LIRIKË SHPIRTËRORE 55

GODITJE 56
NËPËR KOHË 57
KALTËRSI 58
KËMBËNGULJE 59
KËNGË 60
FALI 61
PORTRETI NË KORNIZË 62
ÇMALLJE 63
DASHURISË I KËNDUAN 64

FALNI LIRIKAT 65

NJË MALL 66
LIRIKË 67
ËNDËRR E VJETËR 68
RËNIE 69
BEFASISHT 70
TROKITA 71

NDRYSHKU 72

ATJE KU NUK BIE BORA 73

VARGJET MOS M'I PREKNI 74
HARRIMI 75
PA PRITUR 76
GJALLË 77
HIRI 78
E PA THËNË 79
SONTE 80
KËTË NATË 81
PËRPLOT NJË JETË 83

AUTORË TË SAKRIFIKUAR 85

ME THINJA 86
KOT U MUNDOVA 87
PYETJE 88
TË KËRKOVA 89
PORTA E DASHURISË 90
REXHA I NËNËS 91
UNIVERS 93
PA EMËR 95
MË LINI 96

HIJET E SHPIRTIT 97

NËNË 98
PËR NËNËN 99
TË URTËS NËNË 100
NJË JETË 101
GJITHMONË 102
KOHË 103
HYRJE NË PRANVERË 104
MURE 105
DASHURI 106
PORTA IME E LASHTË 107

ZANORET E BARDHA 109

PËRZIERJE 110
ÇUDITËRISHT 111
KTHEHU 112
SHTEGTIM 113
SPROVË 114
NUK ERDHA 115
TË GJALLË 116

LIRIKAT E FJETURA 117

SI TRËNDAFILI 118
PËRJETËSI 119
ÇASTE 120
PËRTEJ PRITJES 121
PËRDITË 122
MALLI 123
ORË E VONË 124
NUK DUA 126
NJË DITË 127
LOZONJARE 128
LULËBARDHA 129
DËSHIRË 130
SI HËNA 131
KËNGË SKOFIARE 132
SORKADHES 133

KUMBIM KËMBANASH 135

ECJE 136
MOSHË DHE VITE 137
TË KËRKOJ 139
TË GJITHË 140
KËRKOJË FALJE 141

SHËNIME PËR AUTORIN 143

PËRMBAJTJA 145

ISBN

Tirazhi
200 copë

Formati
120 X 190

Shtypur në shtypshkronjën
Shkrola Print
Prishtinë
2013